



Datë: 27.03.2026

A.nr. 142/2026

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Arben Mehmeti-Kryetar, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë, me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.142/2026, të datës 05.02.2026, të parashtruar nga ankuesi E.SH, nga Mitrovica, kundër organit të punësimit Ministria e Mbrojtjes, në çështjen juridike “*kërkesë nga marrëdhënia e punës*” duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, s i dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 27.03.2026, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e parakohshme ankesa më numër A.nr.142/2026, e datës 05.02.2026, e parashtruar nga ankuesi E.SH.

A r s y e t i m

Nëpunësi civil, E.SH (*në tekstin e mëtejme referuar: ankuesja*), me datë 05.02.2026, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila është regjistruar nën shenjën A.nr.142/2026, për shkak të mosveprimet të organit të punësimit lidhur me kërkesën e tij të datës 13.01.2026.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 12.02.2026 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Mbrojtjes, ndërsa, Këshilli më datë 23.02.2026, ka pranuar përgjigje në ankesë së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejshme referuar: Kolegji i Këshillit) për vendosje administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 652/2026 të datës 05.02.2026, e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës; Kopjen e ID-së së ankuesit; Vendimin e Këshillit A.nr.1748/2025 të datës 27.11.2026; Vendimin e datës 22.12.2025 të Burimeve Njerëzore të MB-së; Kërkesën e ankuesit të datës 13.01.2026; Aktin përcjellës Nr.59 të datës 13.02.2026; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 12.02.2026; Përgjigje në kërkesë e datës 23.02.2026; Akt Emërimit e ankuesit të datës 05.06.2026; Raportin e ristrukturimit i datës 19.12.2026;

Kolegji i këshillit pasi ka shqyrtuar provat materiale të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi se ankesa e ankuesit, **është e parakohshme, sepse:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës Kolegji i Këshillit fillimisht konstatoi se sipas Akt Emërimit me numër protokolli: 5/593/2025, të datës 05.06.2025, ankuesi ishte i punësuar në pozitën Specialist i Administrimit të Rrjetave, në kuadër të Ministrisë së Mbrojtjes, ndërsa organi i punësimit i ishte nënshtruar procesit të ristrukturimit, dhe procedurave ankimore në Këshill, Komisioni i Ristrukturimit kishte nxjerrë Raportin e ri Nr.4205 të datës 19.12.2025 përmes të cilit e kishte rekomanduar që ankuesi të sistemohet në pozitën “Analistë i Vlerësimit të Cenueshmërisë në Aplikacione”.

Drejtori i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore në kuadër të Ministrisë së Mbrojtjes, duke vepruar sipas rekomandimit të Komisionit të Ristrukturimit, me datë 22.12.2025 ka nxjerrë vendimin me numër:6687 përmes të cilit ankuesin e transferohen në mënyrë të përhershme në pozitën “Analistë i Vlerësimit të Cenueshmërisë në Aplikacione”, kurse ankuesi aktin për transferimin e tij nuk e konteston.

Mirëpo ankuesi me datë 13.01.2026 i drejtohet njësive organizative brenda organit të punësimit, respektivisht KOMNJSK-së me kërkesën që pozitën në të cilën është transferuar të procedohet tutje dhe të dërgohet tek komisionin përkatës për pozitat e ekspertëve sipas legjislacionit për pagat e zyrtarëve publik, kurse KOMNJSK përmes aktit përcjellës nr.59 të datës 13.01.2026 kërkesën e ankuesit e ka deleguar tek njësia e titulluar G1SHPFPSK në kuadër të Ministrisë së Mbrojtjes.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se organi po ia mohon të drejtën që i takon me synimin se pozita në të cilën është transferuar duhet të përfshihej në listën e ekspertëve sipas ligjit për pagave të zyrtarëve publik, me kërkesën që Këshilli të detyroi Ministrinë e Mbrojtjes të dërgoi kërkesë tek Komisioni Shtetërorë për Vlerësimin e Sistemeve Strategjike, si dhe ta detyrojë komisionin përkatës të shqyrtoj kërkesën e ankuesit.

Kolegji i Këshillit lidhur me pranueshmërinë e ankesës së ankuesit, ju referua dispozitave të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, gjegjësisht nenin 98 paragrafin 1 dhe 2, ku përcaktohet se: *1. Procedura administrative nisur sipas kërkesës, do të përfundojë sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se sa afati i përcaktuar me ligj të veçantë për atë lloj procedure. 2. Në rast se ligji i veçantë nuk ka paraparë një afat, siç është paraparë në paragrafin 1 të këtij neni, afati i përgjithshëm i zbatueshëm për përfundimin e procedurës administrative është dyzetepesë (45) ditë nga fillimi i saj, si dhe nenit 127 paragrafi 1 dhe 4 i të njëjtët ligj ku përcaktohet se: “1. Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ. 4.*

Ankesa kundrejt heshtjes administrative mund të parashtrohet jo më herët se shtatë (7) ditë dhe jo më vonë se dy (2) muaj pas skadimit të afatit për njoftimin e aktit administrativ...”, e në kuptim të këtyre dispozitave ligjore si dhe duke u bazuar në shkresat e lëndës, Kolegji konstaton se ankesa e ankuesit e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datë 05.02.2026 është e parakohshme, pasi që ankuesi ende pa kaluar afati ligjor për përfundimin e procedurës administrative të iniciuar sipas kërkesës së datës 13.01.2026 dhe rrjedhimisht ende pa u përmbushur kriteri kohor lidhur me heshtjen administrative parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, andaj mbi këtë bazë, Kolegji vlerëson se ankesa e ankuesit është e papranueshme në kuptim të nenit 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Në kontekst të mbrojtjes së të drejtave nga marrëdhënia e punës, Kolegji thekson faktin se hedhja poshtë e ankesës A.nr.142/2026, nuk nënkupton mohimin e së drejtës së ankuesit që i njëjti sërish mund të ushtroj ankesë në pajtim me afatet e përcaktuar me nenin 127 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Kështu që, për sa me sipër dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 si dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij Vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda: A.nr.142/2026, datë 27/03/2026

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit E.SH;
- Ministrisë së Mbrojtjes (Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore), si dhe;
- Arkivit të KPMSHCK-së.